

VENDIM
Nr.624, datë 21.9.2004

**PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË UJËSJELLËSVE NDAJ
KESH SHA PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2004**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit t’i jepet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ujësjellësve për energjinë elektrike ndaj KESH sh.a. për tremujorin e tretë të vitit 2004, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. KESH sh.a., me këtë fond, të shlyejë detyrimet ndaj ARMO sh.a., e cila të shlyejë detyrimet ndaj Albpetrol sh.a., Patos, në vlerën 222 000 000 (dyqind e njëzet e dy milionë) lekë dhe ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në vlerën 178 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë) lekë.

3. Albpetrol sh.a., me shumën prej 222 000 000 (dyqind e njëzet e dy milionë) lekësh, të shlyejë detyrimet për sigurimet shoqërore, në vlerën 107 000 000 (njëqind e shtatë milionë) lekë dhe ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në vlerën 115 000 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

4. Fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh të përballohet nga fondi i kontigjencës i vitit 2004.

5. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Financave dhe Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E DEBIVE PËR ENERGJINË ELEKTRIKE QË UJËSJELLËSAT KANË NDAJ KESH SHA
DERI NË FUND TË VITIT 2003 DHE QË DO TË SHLYHEN NË TREMUJORIN E TRETË TË
VITIT 2004**

000/lekë

Nr.	Subjekti	Mbetje debitore 31.12.2003 mijë/lekë
1	Ujësjellësi Durrës	82 433
2	Ujësjellësi Fushë-Krujë	988
3	Ujësjellësi Lushnjë qytet	8 230
4	Ujësjellësi Fier	150 686
5	Ujësjellësi Patos	3 377
6	Ujësjellësi Vlorë	20 274
7	Ujësjellësi Novoselë	2 437
8	Ujësjellësi Korçë-fshat	1 129
9	Ujësjellësi Bilisht	1 954
10	Ujësjellësi Pogradec	7 719
11	Ujësjellësi Elbasan qytet	10 000
12	Ujësjellësi Elbasan fshat	100 000

13	Ujësjetlësi Shkodër fshat	1 296
14	Ujësjetlësi Vau i Dejës	404
15	Ujësjetlësi Krastë	41
16	Ujësjetlësi Laç	5 341
17	Ujësjetlësi Mirditë	703
18	Ujësjetlësi Gjirokastër fshat	192
19	Ujësjetlësi Gjirokastër qytet	2 014
20	Ujësjetlësi Libohovë	618
21	Ujësjetlësi Sarandë	164
	Totali	400 000